



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më	
Nr.	prot.

Data: 28.2.2025 | Nr: 230 | Ora: 12:00

**VENDIM**

**MBI**

**MIRATIMIN E DISA ELEMENTËVE PËRMBAJTËSORË TË FLETËS SË VOTIMIT  
PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND, TË DATËS 11.5.2025**

Në mbështetje të nenit 19 pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 97, pika 1, dhe nenit 98, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 6, datë 6.2.2025, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 11 maj 2025”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**VENDOS:**

1. Miratimin e disa elementëve përmbajtësorë të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 maj 2025, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 28.2.2025 Nr: 230  
Ora: 12:00



“Mbi miratimin e disa elementëve përmbajtësorë të fletës së votimi për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 maj 2025”



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

**Lidhja 1**

**Elementët përmbajtësorë të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025**

- 1) Stema e Republikës,
- 2) Logo KQZ,
- 3) Shkrimet:
  - a) Republika e Shqipërisë
  - b) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
  - c) Fletë votimi,
  - d) Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 11 Maj 2025
  - e) Qarku
  - f) QV nr.
- 4) Emri i subjektit zgjedhor (parti politike/koalicion/ kandidat i propozuar nga zgjedhësi)
- 5) Emri dhe mbiemri i kryetarit të subjektit zgjedhor (parti politike/koalicion)
- 6) Shkronjat nistore të subjektit zgjedhor (parti politike/koalicion),
- 7) Logo e partisë, ose koalicionit të regjistruar si subjekt zgjedhor,
- 8) Emri dhe mbiemri i kandidatëve në listën shumëmemërore të renditur,
- 9) Emri dhe mbiemri i kandidatëve në listën shumëmemërore të cilët marrin votë preferenciale,
- 10) Numri rendor për parti politike ose koalicionin e partive,
- 11) Kuadrat (i bardhë) ku bëhet shënimi i votuesit për partinë, ose koalicionin,
- 12) Kuadrat (i bardhë) ku vendoset shënimi i votuesit për kandidatët e votimit preferencial.